



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr.548 Regj

Lushnje, më 07.09.2021

VENDIM –SHPALLJE

*(Lidhur me ekzekutimin e “Urdhërit të Ekzekutimit” të titullit ekzekutiv të debitorit)*

Në Lushnje, sot më datë 07.09.2021,

Unë Brikena Luto, me detyrë Përmbaues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbaimit Lushnje, pasi studiova aktet proceduriale të çështjes përmbaimore nr.548, datë 25.08.2021 bazuar në urdhërin e ekzekutimit Ekzekutimit nr.1346 (927) të lëshuar në datë 09.12.2020 nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë.

K O N S T A T O V A :

Se në datë 25.08.2021 është depozituar pranë Zyrës së Përmbaimit Lushnje kërkesa e kreditorit Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Korçë së bashku me Ekzekutimit nr.1346 (927) të lëshuar në datë 09.12.2020 nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, për procesverbalin e konstatimit të kundravajtjes administrative datë 01.12.2017 me palë:

- Kreditor: Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë
- Debitor : Bujar Ismail Islamaj
- Me objekt:Gjobë administrative në shumën 20 000 lekë plus 10 % taksa përmbaimore ne shumene 2 000 leke dhe 20% TVSH ne shumen 400 lekë, gjithsej 22 400 lekë

Nga ana e Zyrës së Përmbaimit Lushnje ka filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile si dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “ *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbaimit Gjyqësor*”, i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Bujar Ismail Islamaj nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenet 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe neni 517 të Kodit të Proedurës Civile

duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike e debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kreditore buxhtetit të shtetit për gjobën administrative në vlerën 22 400 lekë.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, dhe 144/a si dhe 517 të Kodit të Proçedurës Civile dhe ligjit nr.8730, datë 18.01.2001 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbimor Gjyqësor”, i ndryshuar.

#### V E N D O S A :

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 08.09.2021 – 27.09.2021 të debitorit Bujar Ismail Ismailaj;
2. Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vëndbanimin e fundit të palës debitore , një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbimit Lushnje, një kopje dërgohet për afishim pranë në këndin e publikimeve Njësisë Administrative Kolonjë, Bashkia Lushnje , një kopje dërgohet për afishim pranë në këndin e publikimeve të Bashkisë Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Bujar Ismailja me banim në Lumth, Njësia Administrative Kolonjë, Bashkia Lushnje;
4. Pala debitore Bujar Ismail Ismailaj me banim në Lumth, Njësia Administrative Kolonjë, Bashkia Lushnje të paraqitet pranë Zyrës së Përmbimit Lushnje në lagjen “ Çlirim” , kati i parë, hyrja mbarapa në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe të marr kontaktet me përmbimuesin gjyqësor të çështjes përmbimore për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim detyruar sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

*U shpall në Lushnje, sot më datë 07.09.2021.*

